REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. i Dokumentit: 24.18.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Ejup Simnica (Udhëheqës i ekipit) dhe Valbona Pllana (Anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 9

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli 14

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 22

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA 23

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak 26

Shtojca IV: Letërkonfirmimi 29

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetorë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit[1], të datës 20.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim të çështjes tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e pasurive nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor dhe Drejtorin e Sekretariatit me stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

[1] Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit "

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Pasqyrat financiare vjetore -Theksimi i Çështjes pasqyron dobësitë në kontrolle për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e pasurive.	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes në 2016 dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për të siguruar plotësinë, saktësinë dhe prezantim të drejtë të pasurisë në 2017. (shih nënkapitulli 1.1).
Qeverisja - zbatimi i rekomandimeve të AP-së, nga viti i kaluar ishte në nivel të ulët.	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë mekanizmat përcjellës për implementimin e planit të veprimit nga personat përgjegjës për zbatimin e plotë të rekomandimeve të AP-së, brenda afateve kohore të përcaktuara (shih çështjen 2).
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm nuk i mbështetë plotësisht zhvillimet në këtë fushë.	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies, raportimit menaxherial, menaxhimit të rrezikut duke ngritur efektivitetin operacional të mbështetur nga NJAB (shih çështjen 3 dhe 4).
Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk është në nivel të kënaqshëm.	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë zbatimin e plotë të rekomandimeve të NJAB-së,derisa KA duhet të forcojë rolin e vet për mbajtjen e menaxhmentit më përgjegjës për zbatimin e këtyre rekomandimeve (shih çështjen 4).
Menaxhimi financiar - ende ka dobësi që kërkojnë përmirësime rreth menaxhimit të personelit, shpenzimeve si dhe menaxhimit të pasurisë.	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të ndërmerr veprime adekuate për të siguruar që proceset në fushat e cekura zbatohen dhe zhvillohen në pajtueshmëri të plotë me rregullat e përcaktuara (shih kapitullin 3).

Përgjigja e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor– auditimi 2016

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

1. Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullores MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e pasurive fikse nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme, si:

- Ato janë të regjistruara me vlerën blerëse duke mos kalkuluar zhvlerësimin. Si rezultat i kësaj, vlera neto e pasurive nën 1,000€ është e mbivlerësuar; dhe
- KGJK ende nuk ka arrite të kryejë regjistrimin e të gjitha pasurive që i ka në posedim dhe shfrytëzim dhe të krijojë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive.

Opinioni jonë nuk modifikohet për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

KGJK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Gjithashtu, KGJK ka raportuar në pajtueshmëri me kërkesat për raportim të jashtëm, më përjashtim të raportimit të obligimeve të cilat nuk janë raportuar me kohë si dhe nuk është bërë prerja e saktë e periudhave mujore. Kjo është shpalosur në detaje të kapitulli 3.4. Obligimet e papaguara.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar (UD), me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

1.3 Rekomandimet

Për çështjen e theksuar te baza për opinion, ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të siguroj se është bërë një analizë e detajuar e shkaqeve, për theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, të ndërmerren veprimet e duhura që e gjithë pasuria të regjistrohet dhe t'i nënshtrohen zhvlerësimit duke aplikuar normat përkatëse të tyre. Me tutje, menaxhmenti duhet të bëjë një rishikim detaj të draft PFV-ve, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KGJK që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësori i vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha Organizatat Buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në KGJK lidhur me obligimet statutore dhe cilësinë e raportimit menaxherial pasqyron situatë progresive. Megjithëse, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të KGJK-së.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i jashtëm është i ulët. Pyetësori i vet-vlerësimit është plotësuar, mirëpo për disa pyetje nuk janë ofruar përgjigje e në disa raste tjera përgjigjet nuk mbështeten me dokumentacion përkatës. Për më tepër menaxhmenti nuk ka hartuar një listë të identifikimit dhe menaxhimit të rrezikut për të mundësuar eliminimin e pengesave të mundshme krahas përmbushjes së objektivave.

Sa i përket cilësisë së raportimit të brendshëm, raportimet bëhen me shkrim dhe në formë elektronike, megjithëse kohëve të fundit menaxhmenti nuk ka mbajtur takime të rregullta. Derisa NJAB kishte kryer disa raporte të auditimit, të cilat ishin të një cilësie të mirë, mirëpo rekomandimet e tyre nuk janë zbatuar sa duhet nga menaxhmenti.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e KGJK-së për vitin 2015, ka rezultuar me 11 rekomandime kryesore. KGJK ka përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dy (2) rekomandime janë zbatuar, katër (4) janë në proces dhe pesë (5) nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 – Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura

KGJK ka hartuar me kohë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit 2015. Mirëpo kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i rekomandimeve monitorohet formalisht nga menaxhmenti dhe merren veprimet e nevojshme në rastet e ngecjes. Andaj pjesa më e madhe e tyre nuk janë zbatuar.

Rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar ndërlidhen kryesisht me procesin e pagesave, vonesat në shlyerjen e obligimeve, si dhe menaxhim jo të mirë të pasurive.

Rreziku

Mos zbatimi i rekomandimeve rritë rrezikun e mos përmirësimit të dobësive të identifikuara. Si rezultat mangësitë e njëjta janë evidente të cilat ndikojnë negativisht në qeverisje dhe menaxhim financiar të organizatës.

Rekomandimi 2

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë se në vazhdimësi është duke e monitoruar progresin e planit të veprimit nga personat përgjegjës për zbatimin e plotë të rekomandimeve të AP-së, brenda afateve kohore të përcaktuara. Veprime shtesë të ndërmerren ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit të këtyre rekomandimeve.

2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për KGJK-në të cilat së bashku më të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohen në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do ta jap gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF në rritjen e efektivitetit të procesit dhe zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, kemi shqyrtuar disa çështje të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentet e tij. Bazuar në këtë kemi vërejtur se KGJK në disa pyetje nuk ka ofruar përgjigje, ndërsa për disa përgjigje të dhëna nuk ka dokumentacion mbështetës që do të konfirmonte saktësinë e tyre. Në vijim kemi shpalosur detajet:

- "Ambienti i kontrollit", KGJK ka hartuar planin vjetor dhe strategjik të tyre. Për hartimin e tyre është caktuar një komision me përbërje të gjërë nga Këshilli, Sekretariati, përfaqësuesit e Gjykatave, përfaqësues të shoqërisë civile dhe këshilltarë ndërkombëtar nga EROL-i, EULEX-i dhe IPA[2]. Mirëpo kosto e strategjisë nuk është në përputhje dhe e mbështetur nga KASH[3] (2014-2019);
- "Menaxhimi i rrezikut", KGJK nuk ka përpiluar një listë të rreziqeve, përfshirë përshkrimin e tyre, masat që do të ndërmerren për menaxhimin dhe zvogëlimin e tyre si dhe personat përgjegjës;
- "Aktivitetet e kontrollit", plani i prokurimi përgatitet në përputhje me disponueshmërinë e fondeve buxhetore dhe prioriteteve të KGJK-së. Plani final i prokurimit i dërguar në AQP, nuk është azhurnuar gjatë vitit. Me tutje, nga 26 pyetje lidhur me aktivitetet e kontrollit, vetëm në shtatë (7) prej tyre janë ofruar përgjigje;
- "Informimi dhe komunikimi", lidhur me raportimin në kohën e duhur për vendimmarrje, nuk përgatiten raporte. Sa i përket kësaj pyetje, KGJK nuk ka dhënë përgjigje; dhe

[2] EROL - Programi për sundimin efektiv të ligjit, EULEX-Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, IPA-Instrumente të para-aderimit në Bashkimin Evropian.
[3] Korniza afatmesme e shpenzimeve.

- "Aktivitetet e monitorimit", nuk monitorohet progresi i arritjes së objektivave dhe nuk ka ndonjë analizë lidhur me shkaqet e dështimit të mundshëm të arritjes së tyre.

Rreziku Mosplotësimi si duhet i pyetësorit të vet-vlerësimit paraqet mungesë të informacionit rreth funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Mungesa e proceseve për identifikimin e rreziqeve rezultojnë me zvogëlimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë me kohë ndaj sfidave të ndryshme gjatë menaxhimit, si dhe mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për këto procese. Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë se janë ofruar informacione të plota rreth funksionimit të MFK-së. Plotësimi i pyetësorit duhet përcillet me mekanizëm të rishikimit për konfirmimin e saktësisë së të dhënave të prezantuara. Më tutje, duhet siguruar hartimi i planit për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve që mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit KGJK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Në kuadër të KGJK-së operojnë 12 njësi, si: Sekretariati i KGJK-së (SKGJK), shtatë (7) Gjykata Themelore, Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme, Njësia e Shqyrtimit të Përformancës dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor. PFV-të e të gjitha njësive konsolidohen në PFV-të e KGJK-së dhe të konsoliduara dërgohen në Thesar si një tërësi.

Njësitë e KGJK-së kanë përgjegjësitë e tyre të ndara nga SKGJK të bartura me Udhëzimin Administrativ 01/2015 të nxjerrë në muajin janar 2016, dhe operojnë sipas strukturës së tyre organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse.

Njësitë e KGJK-së janë në konsolidim e sipër drejt raportimit të rregullt për aktivitetet e tyre operacionale dhe performancës në SKGJK. Andaj kontrollet menaxheriale janë zbatuar në sistemin kryesor financiar të KGJK-së, kishte raportime dhe barazime për shpenzimet dhe të hyrat në mes të njësive dhe SKGK-së. Megjithëse kohët e fundit menaxhmenti nuk takohet rregullisht.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me katër (4) anëtarë - Drejtori i NJAB dhe tre (3) auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi kontrollit e brendshme. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv Auditimi. Komiteti i Auditimit (KA) është i themeluar dhe funksional.

NjAB ka përgatitur planin vjetor të auditimit për vitin 2016 të bazuar në vlerësim të rrezikut, prioriteteve dhe fushave të cilat janë cilësuar me rrezik të lartë. Për vitin 2016 ishte tejkaluar plani i auditimit, duke realizuar tetë (8) auditime, nga shtatë (7) të planifikuara.

Raportet NjAB-se ishin të një cilësie të mirë, me të gjetura dhe rekomandime të qarta. Përmes të cilave menaxhmentit i është ofruar pasqyrë e qartë për funksionimin e kontrolleve të brendshme si dhe janë dhënë rekomandime të qarta për përmirësime.

Çështja 4 - Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB – Prioritet i lartë

E gjetura	Raportet e auditimit të brendshëm nuk ishin trajtuar në nivelin e duhur nga menaxhmenti, pasi që një numër i tyre kanë mbetur të pa zbatuara (rreth 36%). Nga gjithsej 50 rekomandimet e dhëna në tetë (8) raportet e auditimit 32 prej tyre janë zbatuar.
Rreziku	Mos implementimi i plotë i rekomandimeve të NJAB ka ndikim negativ në funksionimin e kontrolleve të brendshme si dhe rritë rrezikun që mangësitë e njëjta të përsëriten në vazhdimësi.
Rekomandimi 4	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë bashkëpunim të ngushtë mes menaxhmentit, KA-së dhe NJAB-së për identifikimin e dobësive të kontrolleve të brendshme dhe ndërmarrjen e veprimeve adekuate për zbatimin e rekomandimeve.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KGJK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2016, KGJK ka përdorur 97% të buxhetit final. Menaxhimi dhe raportimi i të hyrave ishte bërë në pajtueshmëri me legjislacionin. Procedurat e prokurimit publik janë realizuar në përputhje me rregullat e përcaktuara.

Përkundër kontrolleve të identifikuara në fushat e lartcekura, nevojitën veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin. Dobësitë janë vërejtur kryesisht të shfrytëzimi i buxhetit (procesimi i pagesave, vonesat në zotimin e mjeteve dhe procesimin e urdhër blerjeve pas faturës), te menaxhimi i personelit (pozitat e mbuluara me Ushtrues Detyre më gjatë se tre muaj, puna jashtë orarit, si dhe tejkalimi i buxhetit për shpenzime të udhëtimeve zyrtare), si dhe te menaxhimi i pasurisë dhe obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,213,900	1,280,231	8,051,611	8,087,041	9,176,728
Totali	1,213,900	1,280,231	8,051,611	8,087,041	9,176,728

Nga tabela më lartë shohim se një trend (i lehtë) i rënies se të hyrave neper vite. Në raport me vitin 2015 ka një rënie prej 35,430€. Nga vlera totale e të hyrave, 1,280,231€ janë lejuar të shpenzohen për nevojat e KGJK-së, ndërsa pjesa e tjetër është transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK). Lidhur me menaxhimin dhe raportimin e të hyrave ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[4]	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**20,465,770**	**20,234,241**	**19,528,929**	**18,791,104**	**18,293,129**
Granti i Qeverisë -Buxheti	19,251,870	18,953,481	18,872,482	17,643,133	16,844,640
Të hyrat vetjake[5]	1,213,900	1,280,231	656,447	1,147,971	1,445,489
Donacionet e jashtme		529	-	-	3,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 231,529€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2016, KGJK ka përdorur 97% të buxhet final, 1% më pak krahasuar me vitin 2015 (që ishte 98%). Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**20,465,770**	**20,234,241**	**19,528,929**	**18,791,104**	**18,293,129**
Pagat dhe Mëditjet	15,011,691	14,661,138	14,016,443	13,511,947	12,469,069
Mallrat dhe Shërbimet	3,613,079	3,987,419	3,932,056	3,601,422	3,717,614
Shërbimet komunale	450,000	382,499	378,092	419,042	464,704
Subvencionet dhe Transferet	250,000	369,059	368,212	380,288	279,589
Investimet Kapitale	1,141,000	834,126	834,125	878,404	1,362,153

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 350,553€. Fillimisht me rishikim të buxhetit ishte rritur për 279,720€, si rrjedhojë e rritjes së pagave për 300€ për gjyqtar për krime të renda, si dhe 66,300€ si bartje e të hyrave vetanake nga viti 2015. Në fund të vitit në këtë kategori janë shtuar 3,427€, ndërsa në kuadër të shkurtimeve buxhetore kjo kategori është zvogëluar për 700,000€;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rrit për 374,340€. Fillimisht ishte rritë buxheti për 521,530€ (200,000€ janë transferuar nga kapitalet, 9,000€ nga shërbimet komunale, 312,001 i janë ndarë buxhet shtesë më kërkesë të KGJK-së, si dhe 529€ bartja e donacionit nga vitet paraprake), mirëpo në fund të vitit si rezultat i kursimeve buxhetore, me vendim të Qeverisë të datës 28.12.2016, buxheti në këtë kategori ishte shkurtuar 147,190. Ndërsa te shërbimet komunale buxheti ishte reduktuar për 67,501€;

[4] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
[5] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritë 119,059€, si rezultat i vendimit të Qeverisë për buxhet shtesë; dhe
- Te investimet kapitale, buxheti final ishte reduktuar për 306,874€. Prej tyre 200,000€ janë transferuar te mallrat dhe shërbimet, ndërsa pjesa tjetër ishte reduktuar si rezultat i kursimeve/shkurtimeve buxhetore.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e KGJK-së. Në këtë kategori janë shpenzuar 14,016,443€ apo 96% të buxhetit final.

Çështja 5 - Plotësimi i pozitave me ushtrues detyre më gjatë se tre muaj – Prioritet i lartë

E gjetura

Sipas Ligjit të Shërbimit civil Nr.03/L-149 neni 30, në rast se mbetet ndonjë pozitë e lirë në shërbimin civil, Ushtruesi i Detyrës (U.D) nuk mund të ushtrojë aktivitetin më gjatë se tre (3) muaj.

Nga ekzaminimet tona në SKGJK dhe disa Gjykata Themelore (Prishtinë, Ferizaj dhe Mitrovicë) kemi vërejtur dhjetë (10) raste të pozitave me U.D. të cilat kanë tejkaluar afatin ligjor, ndër të cilat edhe pozita menaxheriale, si:

- Në SKGJK janë tri (3) raste me UD Drejtori i departamentit për buxhet dhe financa nga muaji shtator 2014; Drejtori i Zyrës së Evidencës Penale nga muaji korrik 2015; Zyrtarja e lartë në njësinë e evidencës penale në SKGJK nga dhjetori 2015;
- Në Gjykatën Themelore në Ferizaj janë katër (4) raste me UD, si: Zyrtari i shpenzimeve, Zyrtari Çertifikues dhe Zyrtari i personelit nga muaji dhjetor 2015 dhe Shefi i zyrës për shërbime të përbashkëta nga muaji janar 2016; dhe
- Në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë tri (3) raste me UD, si: Zyrtari Financiar dhe Zyrtari Çertifikues nga muaji dhjetor 2015, ndërsa Zyrtari Kryesor Financiar nga muaji janar 2016.

Pozitat e plotësuara me U.D. në SKGJK kishin kaluar periudha të gjata kohore, madje me vite, duke ju shmangur procedurave të rregullta, konkurrencën e hapur dhe transparencën për plotësimin e tyre.

Rreziku Praktika e mbulimit të pozitave të lira me ushtrues detyre përfshirë këtu edhe pozita menaxheriale më tepër se tre (3) muaj përveç shmangies ligjore, rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Kjo mund të ndikojë edhe në performancën e organizatës në përgjithësi.

Rekomandimi 5 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të ndërmerr veprime për të ndërprerë praktikat e mbulimit të pozitave me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta sipas përcaktimit ligjor.

Çështja 6 – Mospërputhje e vendimit për kompensimet me Ligjin e Punës – Prioritet i mesëm

E gjetura Në vitin 2014, KGJK ka nxjerrë vendim për kompensimin e gjyqtarëve për punë jashtë orarit, për kujdestari, gjatë fundjavave dhe festave zyrtare. Vendimi parasheh kompensim prej 20€ në ditë, pavarësisht sa orë është punuar. Ky kompensim (vendim) nuk është në harmoni me parimet e ligjit të punës (Nr.03/L-212) që parasheh kompensimet sipas orëve të shpenzuara në punë.

Rreziku Pagesat për punë shtesë (kujdestari) të gjyqtarëve në këtë mënyrë rritë rrezikun për kompensim jo të drejtë për punën e kryer. Pagesat fikse, pavarësisht orëve të punuara nuk janë vlerësime objektive dhe mund të paraqesin pagesa të parregullta.

Rekomandimi 6 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë se vendimi për kompensime për punë jashtë orarit të jetë në harmoni me rregullat e përgjithshme dhe parimet e Ligjit të punës 03/L-212, për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera.

Çështja 7 - Dobësi në procedurat e rekrutimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Me konkursin e shpallur me 12.07.2016 për pozitën "Roje sigurimi - 15 pozita", nuk janë respektuar afatet e përcaktuara me udhëzim administrativ 14/2011. Procesi është përcjellë me vonesa pothuaj në të gjitha fazat: testimi me shkrim është vonuar për 22 ditë, intervistat janë mbajtë më 14 ditë vonesë, ndërsa nënshkrimi i kontratës me kandidatët e sukseshëm është vonuar për katër (4) muaj apo pas 125 ditëve.

Rreziku Mosrespektimi i afateve kohore të përcaktuara mund të rezultojë me ankesa në institucionet kompetente për monitorimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë gjatë proceseve të rekrutimit si dhe mund të rezultojnë me mos plotësimin e pozitave.

Rekomandimi 7 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë proces transparent dhe efektiv të rekrutimit të punonjësve duke respektuar të gjitha kërkesat ligjore përfshirë procedurat dhe afatet e parapara.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë komunalitë në vitin 2016 ishte 4,369,918€, prej tyre janë shpenzuar 4,310,148€, ose 99% e buxhetit. Në kuadër të tyre, shpenzimet me të mëdha ishin për: shpenzimet e përfaqësimit dhe avokaturës me 1,102,411€, shpenzimet e shërbimeve postare 1,018,885€, si dhe shpenzimet për udhëtime zyrtare 308,532€. Testimi i kësaj kategorie ka vënë në pah çështjet në vijim:

Çështja 8 – Tejkalim i shpenzimeve të planifikuara për udhëtime zyrtare - Prioritet i lartë

E gjetura Shuma e planifikuar/buxhetuar në vitin 2016 për shpenzime të udhëtimit jashtë vendit ka qenë 157,000€, ndërsa KGJK ka shpenzuar rreth 308,532€[6]. Nga këto mjete janë realizuar 91 udhëtime jashtë vendit. Shumica prej tyre në Shqipëri, 38 në Tiranë dhe 20 në Durrës. Nga auditimi i pesë (5) mostrave për udhëtime në vlerë 64,177€ kemi vërejtur se përveç shpenzimeve të udhëtimit prej 21,630€ për të cilat ekzistonin agjendat e udhëtimeve, të tjerat ishin bërë pa agjenda si dhe mbyllja e avansit nuk është bërë brenda afatit të paraparë prej 15 ditësh siç parasheh neni 8 i udhëzimit administrativ 2004/7.

Po ashtu, kërkesat për këto udhëtime zyrtare nuk janë të plotësuara sipas udhëzimit administrativ 2004/7 për udhëtimet zyrtare (MSHP), dhe UA 04/2014 të nxjerrë nga KGJK-ja. Me tutje nuk është plotësuar vendimi për lejimin e udhëtimeve siç kërkohet me UA të KGJK-së.

[6] Kjo vlerë përbën 7% e shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime.

Rreziku Mbishpenzimi në përqindje të madhe e një nënkategorie të caktuar vë në pah planifikimin e dobët të aktiviteteve dhe shpenzimeve. Kjo rritë rrezikun që aktivitete tjera të planifikuara të mos realizohen dhe si pasojë ndikon negativisht në realizimin e objektivave të përcaktuara. Mospërmbushja e kërkesave/prcedurave mund të ndikoj në menaxhim jo të mirë të buxhetit.

Rekomandimi 8 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë që mjetet shpenzohen sipas planit dhe prioriteteve, për qëllime të rritjes së efikasitetit dhe performancës së organizatës. Mjetet e taksapaguesve të shpenzohen me kujdes të shtuar për tu ofruar atyre shërbime sa më cilësore.

Çështja 9 – Zotimi dhe urdhërblerja, pas pranimit të faturës - Prioriteti i mesëm

E gjetura Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet zotimi, pastaj të pranohet malli apo shërbimi dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në tetë (8) pagesa kemi vërejtur se zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja ishin bërë pas pranimit të faturës, në kundërshtim me rregullën e Thesarit 01/2013 shpenzimi i parave publike. Vonesat në nxjerrjen e urdhërblerjeve janë prej katër (4) deri në 90 ditë, ndërsa zotimi i mjeteve është bërë me vonesë prej 70 ditëve.

Rreziku Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë në vonesa të ekzekutimit të pagesave. Pranimi i faturës dhe mallrave para procesimit të urdhërblerjes rrit rrezikun që të pranohen mallra dhe shërbime jashtë kërkesave të parapara për nga sasia dhe cilësia.

Rekomandimi 9 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor i KGJK duhet të sigurojë që blerjet të bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet, respektivisht çdo furnizimi t'i paraprijë urdhër blerja. Furnizimet dhe procesimi i pagesave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPP-në dhe me rregullat e Thesarit.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 369,059€. Prej tyre janë shpenzuar 368,212€, ose afro 100%.

Kategoria e subvencioneve dhe transfereve shfrytëzohet për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa bazë. Lidhur më këtë KGJK ka vendosur kritere dhe procedura të qarta për kompensimin e dëmeve. Gjatë testimit në këtë kategori nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për të raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vlerë 834,126€ ishte shpenzuar në tërësi.

Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar pesë (5) pagesa në vlerë 288,795€, dhe kemi verifikuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në Programin për Investime Publike (PIP) dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Gjithashtu nëse gjatë vitit ka ndodhur ndonjë ndryshim lidhur me projektet e planifikuara. Ne nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi në menaxhimin e tyre.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria me vlerë mbi 1,000€ në KGJK arrinë vlerën prej 15,946,273€, ndërsa pasuritë nën vlerën prej 1,000€ janë 971,144€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores së MF 02/2013 për menaxhimin e pasurisë qeveritare, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive. Bazuar në testet tona shpalosim të gjeturat si në vijim:

Çështja 10 - Mangësi në regjistrin e-pasuria - Prioritet i lartë

E gjetura	KGJK kishte arritur të përfundojë me sukses inventarizimin për vitin 2016, mirëpo nuk ka arritur ta bartë në regjistrin e-pasuria. Problemi në regjistrat e e-pasurive vjen edhe nga vet sistemi, të cilin e administron MAP-i. Menaxhmenti kishte njoftuar zyrtarët e MAP-it dhe MF-së për mos funksionalitetin e sistemit, mirëpo ky problem ende nuk është evituar.
Rreziku	Si rrjedhojë e dobësive të identifikuara në sistemin e-pasuria, ekziston rreziku i dobësimit të kontrolleve në menaxhimin dhe raportimin e pasurive. Kjo shkakton rrezik për keqpërdorimin ose humbjen e tyre.
Rekomandimi 10	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha masat për të adresuar problemet që në vazhdimësi po e përcjellin sistemin e-pasuria në mënyrë që raportimi i pasurive të jetë i saktë dhe i plotë.

3.3 Obligimet e papaguara

Vlera e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 272,728€.

Ne kemi kryer teste lidhur me obligimet në fund të vitit si dhe ato të raportuara në raportet mujore. Bazuar në këtë shpalosim mangësitë si në vijim.

Çështja 11 – Raportim i obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullës financiare nr.02/2013-MF, çdo organizatë buxhetore raporton obligimet përmes raporteve mujore. KGJK kishte bërë progres drejt raportimit më kohë lidhur me obligimet e pa paguara, mirëpo ne vërejtëm dy raste që tregon se cilësia e raportimit ka nevojë ende për përmirësim.

Fatura në vlerë prej 21,645€ ishte pranuar në muajin janar 2016, mirëpo nuk është prezantuar në raportet e obligimeve deri në muajin qershor 2016, ose me pesë (5) muaj vonesë, ndërsa fatura në vlerë 320€ e pranuar në muajin janar, nuk figuronte fare në raportet e obligimeve.

Rreziku Mos raportimi i saktë i obligimeve mujore rritë rrezikun e ekzekutimit të pagesave të dyfishta ose mos pagesës së obligimeve ndaj operatorëve dhe ekspozimit ndaj ndëshkimeve të mundshme nga furnitorët.

Rekomandimi 11 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë kontrolle shtesë sa i përket raportimit të saktë dhe me kohë të obligimeve sipas kërkesave të rregullës së Thesarit dhe të përcillen rregullisht derisa ato të paguhen.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçë për të cilat Kryesuesi i Këshillit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Menaxhmenti kishte hartuar planin për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të tyre ishte shumë i ulët.	
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit	Kryesuesi i KGJK-së duhet sigurojë që janë përmbushur kërkesat ligjore (respektimi i Rregullave të Thesarit) për të ofruar informacione të plota për Ministrin e Financave lidhur me funksionimin e sistemit të MFK-së. Pas plotësimit të listës kontrolluese të vetvlerësimit duhet të aplikohet një mekanizëm për të rishikuar dhe për të konfirmuar saktësinë e saj si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës për të gjitha të dhënat e prezantuara		Në proces të zbatimit	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se kanë hartuar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, si dhe ka caktuar një person përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza mujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.			Nuk është zbatuar

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryesuesi i KGJK-së duhet të siguroj një bashkëpunim të ngushtë në mes të menaxhmentit dhe NJAB-së për të identifikuar mangësitë e kontrolleve të brendshme dhe të ndërmerr veprime shtesë që rekomandimet e kësaj njësie të gjejnë zbatim në praktikë. Më tej, KA duhet të forcojë rolin e vet në këtë proces, të mbaj takime të rregullta dhe të mbaj menaxhmentin më përgjegjës për implementimin e rekomandimeve.		Në proces të zbatimit	
3.3 Planifikimi dhe realizimi buxhetit	Kryesuesi duhet të siguroj se me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Më tutje, të siguroj se të gjitha shpenzimet janë regjistruar në kategoritë ekonomike adekuate.	Është zbatuar		
3.4 Prokurimi-Zotimi i mjeteve pas pranimit të faturës	Kryesuesi i KGJK-së duhet të siguroj rritjen e efikasitetit në funksionimin e kontrolleve të brendshme ekzistuese në mënyrë që blerjet të bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet e mjaftueshme.			Nuk është zbatuar
3.4 Prokurimi-Procesimi i urdhërblerjes pas pranimit të faturës	Kryesuesi duhet të forcojë kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP -në, dhe me rregullat e Thesarit.			Nuk është zbatuar
3.4Prokurimi-Vonesa në ekzekutimin e pagesave	Kryesuesi duhet të siguroj mbikëqyrje të rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.			Nuk është zbatuar

3.5.2Pagat dhe Mëditjet	Kryesuesi i KGJK-së duhet të siguroj se menaxhimi i kompensimeve për punë jashtë orarit, bëhet në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Në rastet kur kërkohet nevoja për punë jashtë orarit, duhet të paraqitet dhe të aprovohet kërkesa nga nivelet përgjegjëse. Më tej të sigurohet se orët e realizuara për punë jashtë orarit nuk tejkalojnë limitet e përcaktuara.	Është zbatuar		
3.7Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerren veprimet e duhura që sistemi e-pasuria të futet sa më shpejtë në përdorim. Në rast nevoje zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit e-pasuria.			Nuk është zbatuar
4.5.2 Obligimet e papaguara	Kryesuesi i KGJK-së duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të identifikuar shkaqet e mos raportimit të drejt të obligimeve të papaguara, dhe të sigurojë se raportimi i tyre bëhet në përputhje me kërkesat. Të gjitha faturat e papaguara duhet të përfshihen në raportin mujor të obligimeve dhe vlera e tyre duhet të përcjellët deri në pagesën e tyre.		Në proces të zbatimit	

Shtojca IV: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT – SECRETARIAT

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Vahid Limani .....

Drejtor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës - UD,

Data: 11 .Maj.2017, Prishtinë.